

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**PKL-KZZ Nr. 29/08**  
**29 dhjetor 2009**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Supreme e Kosovës** në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i kolegjit, dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Miftar Jasiqi dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga procesmbajtësja Judit Eva Tatrai,


Në lëndën penale kundër të akuzuarit **Nexhat Mazreku**, të lindur më 1 prill 1961 në fshatin Mamushë, komuna e Prizrenit, dhe **Shefki Kayserli**, të lindur më 30 gusht 1964 në Prizren, të dy të akuzuar, të shpallur fajtorë dhe të dënuar për veprën penale të Mashtrimit në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 261 (2) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), lidhur me nenin 23 të KPPK-së,

Duke vendosur mbi Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitura më 21.03.08 nga Avokati mbrojtës Haki Lecaj në emër të të pandehurit Shefki Kayserli dhe nga Avokati mbrojtës Vahid Halili në emër të të pandehurit Nexhat Mazreku, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës (Ap. 528/07), të datës 6 shkurt 2008, në seancën e mbajtur më 29 dhjetor 2009, pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit,

Lëshon këtë

## **AKTGJYKIM**

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prishinës (P. Nr. 595/05), i datës 13 qershor 2007, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës (Ap. 528/07), i datës 6 shkurt 2008, **ANULOHEN** dhe lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën Komunale të Prishtinës (P. Nr. 595/05).



## ARSYETIM

### I. Historia procedurale

Gjykata Komunale e Prishtinës me Aktgjykimin e datës 13 qershor 2007 ka shpallur të pandehurit fajtorë për Mashtrim në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 261, paragrafin 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), lidhur me nenin 23 të KPPK-së. Të dy të pandehurit janë dënuar me nga një (1) vit burgim.

Të pandehurit dhe Prokurori publik kanë ushtruar ankesë ndaj këtij Aktgjykimi. Gjykata e Qarkut të Prishtinës në kolegjin e përbërë nga tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë me Aktgjykimin e datës 6 shkurt 2007 ka refuzuar ankesat si të pabaza dhe ka vërtetuar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

Më 21 mars 2008, Avokati mbrojtës Haki Lecaj në emër të të pandehurit Kayserli ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të lartpërmendura. Po ashtu më 21 mars 2008, Avokati mbrojtës Vahid Halili në emër të të pandehurit Mazreku ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtyre aktgjyqimeve.

### II. Çështjet e ngritura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesat janë përsëritje e çështjeve të ngritura nga Avokatët mbrojtës në ankesat e tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale. Mbrojtja përsëri pretendon se:

- Kolegji nuk është formuar në përputhje me ligjin,
- Gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë gjykatë kompetente për gjykimin e rastit,
- Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka tejkaluar aktakuzën,
- Dispozitivi i Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban përshkrim faktik lidhur me faktet vendimtare.

Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës në mendimin e tyre të datës 10 prill 2008, pranon se kërkesat duhet të refuzohen si të pabaza pasi që shkeljet e pohuara të ligjit nuk ekzistojnë.



### III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Kërkesat janë paraqitur me kohë dhe janë të pranueshme. Ato po ashtu janë të bazuara në bazë të nenit 451, paragrafit 1, pikës 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut mbështeten në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me nenin 403, paragrafin 1 të KPPK-së.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur më 12, 16, 19 prill, pastaj më 2, 10 maj dhe më 13 qershor 2007. Kolegji ka qenë i përbërë nga një (1) Gjyqtar ndërkombëtar si Kryetar i kolegjit dhe dy (2) Gjyqtarë Porotë. Në seancën e 2 majit, Gjyqtari Porotë Shaban Gerxhaliu është zëvendësuar me Gjyqtarin Porotë Tahir Gashin.

Në këtë pjesë të procesverbalit të seancës së shqyrtimit gjyqësor shkruan si më poshtë:

*“Kryetari i kolegjit: Mirëdita. Po vazhdojmë me gjykimin.... Sot, për shkak se Gjyqtari Porotë, Shaban Gerxhaliu është i sëmurë, ne e kemi zëvendësuar të njëjtin me një gjyqtar të ri i cili Tahir Gashi. A ka ndonjë kundërshtim për këtë anëtar të ri të kolegjit?”*

*Nuk kishte asnjë kundërshtim.*

Gjykimi pastaj ka vazhduar me marrjen në pyetje të dëshmitarëve sikur asgjë të mos kishte ndodhur.

Ky vazhdim i thjeshtë përbën një shkelje esenciale të nenit 403, paragrafit 1, pikës 1 të KPPK-së, në të cilën shkruan:

*Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: 1) Përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari ose gjyqtari porotë i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi.*

Zëvendësimi i një anëtari të kolegjit nuk është rreptësisht i ndaluar me ligjin e procedurës në Kosovë. Edhe pse kryetari i kolegjit dhe anëtarët e kolegjit do të jenë vazhdimisht të pranishëm në shqyrtim gjyqësor (neni 332, paragrafi 1 i KPPK-së), ligji nuk e përjashton ndryshimin në përbërjen e kolegjit.

Sidoqoftë, procedurat rigorozë janë përcaktuar me nenin 345, paragrafin 1 të KPPK-së të cilat duhet të përmbushen në rast të zëvendësimit të gjyqtarit.



*Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.*

Prandaj shqyrtimi gjyqësor duhet, si rregull i përgjithshëm, të filloj nga fillimi, p.sh. me leximin e aktakuzës (neni 357 i KPPK-së). Gjatë rrjedhës së këtij gjykimi të ri mund të ngritet pyetja nëse dëshmitë e marra në gjykimin e mëparshëm – dhe ligji është shumë i qartë sa i përket kësaj duke i përdorur fjalët *gjykimi i mëparshëm* duhet të merren përsëri. Lidhur me këtë neni 345, paragrafi 1 i KPPK-së mundëson përjashtime nga rregulli i përgjithshëm që të gjitha dëshmitë duhet të paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor duke i dhënë mundësinë kolegjit pas dëgjimit të palëve të vendosin mos t'i marrin në pyetje përsëri dëshmitarët por që ti lexojnë dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

Si rezultat procedura në rast të zëvendësimit të një anëtari të kolegjit udhëhiqen në mënyrë strikte dhe janë absolutisht të qarta: gjykimi pajtjetër pa ndonjë zgjedhje tjetër duhet të fillojë përsëri nga fillimi me leximin e aktakuzës. Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve të marra në gjykimin e mëparshëm, kolegji duhet ta marrë mendimin e palëve nëse kanë ndonjë vërejtje kundër leximit të këtyre deklaratave. Përmes kësaj procedure sigurohet që anëtari i ri i kolegjit në seancë publike është njoftuar sa duhet lidhur me lëndën dhe dëshmitë, që është parakusht thelbësor për një gjykim publik dhe për një gjyqtar të jep mendim informues gjatë këshillimit dhe votimit.

Në lëndën në fjalë asnjë prej këtyre rregullave nuk është respektuar nga gjykata e shkallës së parë. Në vend të fillimit të gjykimit nga fillimi me leximin e aktakuzës, shqyrtimi gjyqësor thjeshtë ja vazhduar me Gjyqtarin Porotë i cili, si pasojë, nuk ka qenë i njoftuar zyrtarisht lidhur me akuzat kundër të pandehurve.

Deklaratat e avokatëve mbrojtës se ana nuk kanë pasur asgjë kundër Gjyqtarit të ri Porotë nuk mund të shihet si marrëveshje në këtë mangësi.

Së pari, përcaktimi i ligjit se shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë nga fillimi përfshirë leximin e aktakuzës nuk është në dispozicion të palëve. Leximi i aktakuzës është njëra prej pjesëve esenciale të procedurës së shqyrtimit gjyqësor e cila nuk mund të ndryshohet apo anashkalohet nga palët.

Së dyti, palët madje as nuk janë pyetur nga gjykata e shkallës së parë nëse pajtohen me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor. Pasi që pyetja e ngritur nga kryetari i kolegjit i është referuar vetëm vërejtjeve kundër që Gjyqtarit i ri Porotë të jetë anëtar i kolegjit,



ata u përgjigjën – “nuk ka vërejtje” – nuk mund të interpretohet si marrëveshje në mospërfilljen e dispozitave esenciale të procedurës penale.

Kolegji i Gjykatës Supreme nuk pajtohet me interpretimin e kundërt nga gjykata e shkallës së dytë. Është e qartë se nuk ka qenë detyrë e avokatëve mbrojtës të vlerësojnë se çfarë kryetari i kolegjit – i cili ka shtuar pyetjen në mënyrë shumë precize – ka pyetur në të “vërtetë”. Larg nga kjo, është detyrë e gjyqtarëve të sigurojnë që procedura të mbahet në pajtim me ligjin e procedurës. Përveç kësaj për këtë rregull të përgjithshëm neni 333, paragrafi 2 i KPPK-së përcakton qartë se:

*Kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes...*


Kjo detyrë nuk mund ti transferohet mbrojtjes.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë ka dështuar që ti sigurojë dëshmitë përsëri pas që Gjyqtari i ri Portë i është bashkangjitur kolegjit. Dëshmitarët nuk janë marrë në pyetje përsëri. Palët nuk janë pyetur nëse pajtohen me leximin e deklaratave të dëshmitarëve. Deklaratat e dëshmitarëve të marra në kohën para bashkëngjitjes së Gjyqtarit të ri Porotë në kolegji në të vërtetë nuk janë lexuar.

Kundër këtij historiku, kolegji i Gjykatës Supreme përsëri nuk pajtohet me mendimin e gjykatës së shkallës së dytë se ka qenë e qartë se “Gjyqtari Porotë Gashi është njoftuar lidhur me dëshminë e dëshmitarëve të mëparshëm duke e lexuar procesverbalin nga dy seancat e mëparshme të gjykimit”. Neni 345, paragrafi 1 i KPPK-së përcakton rregullat për mënyrën se si një gjyqtar i ri duhet të informohet lidhur me dëshmitë e marra më parë. Me këto rregulla ligji së mban nivelin minimal të kushteve të gjykimit publik e cila është e Drejtë e njeriut (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Ideja e gjykatës së shkallës së dytë që gjyqtari i ri do ta informonte vetën për dëshmitë duke e lexuar procesverbalin (ku?kur?si? ai i ka lexuar të gjitha këto?) e shkelë këtë të drejtë të të pandehurit për një gjykim publik.

Si pasojë, thjeshtë vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor ka krijuar në situatë në të cilën Gjyqtari porotë Tahir Gashi pas shqyrtimit gjyqësor i cili nuk është mbajtur tërësisht në publik, ka marrë pjesë në këshillim dhe votim edhe pse ai nuk ka qenë i informuar në mënyrë të duhur, sipas ligjit, lidhur me akuzat dhe dëshmitë.

Mendimi i gjykatës së shkallës së dytë se këto gabime duke e pas parasysh fuqinë e dëshmimeve kanë qenë të “padëmshme në karakter” nuk mund të pranohet. Nuk është në pajtim me traditat e ligjit Evropian të fokusohemi vetëm në rezultat. Ligji me arsye të mira përcakton shkeljet substanciale të procedurës penale të cilat janë të papranueshme pa marrë parasysh korrektësinë e rezultatit.



Pyetja se a rezulton shkelja e nenit 345, paragrafit 1 të KPPK-së në një kolegji i cili nuk mund të konsiderohet si i formuar në mënyrë të duhur apo në një aktgjykim i cili është marrë nga një gjyqtarë i cili nuk ka marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor është thjeshtë i natyrës akademike, sepse të dy shkeljet konsiderohen si shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, paragrafit 1, pikës 1 të KPPK-së e cila e shpall Kërkesën e të pandehurve për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe në pajtim me nenin 451, paragrafin 1, pikën 2 të KPPK-së.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
PKL.-Kzz. Nr. 29/2008

**Kryetar i kolegjit**

*Norbert Koster*

**Anëtar i kolegjit**

*Miftar Jasiqi*



**Anëtar i kolegjit**

*Avdi Dinaj*

  
 Republika e Kosovës  
 Gjykatë Supreme e Kosovës  
 Prishtinë, Kosovë - 11000

  
 Avdi Dinaj